

Trajtimi që ju ofrohet në shërbimin e urgjencave pediatrike



Vlerësimi

Cili është qëllimi?

Kjo broshurë ju shpjegon mënyrën sesi punon shërbimi dhe ju informon mbi etapat e trajtimit të fëmijës tuaj.

Ekipi i shërbimit në recepsionin e urgjencave pediatrike (SAUP) ju mirëpret dhe angazhohet për t'ju ofruar ndihmë cilësore, si dhe për të bërë sa më të pranueshme pritjen tuaj.

Si fillon trajtimi i fëmijës tuaj?

Kur paraqiteni në urgjencat pediatrike me fëmijën tuaj, qoftë i vetëm, qoftë me ambulancë, pritja sigurohet nga një infermier(e) i(e) specializuar. Ky profesionist i mjekësisë është në dispozicionin tuaj. Në bashkëpunim me një mjek përgjegjës të klinikës, ai përcakton shkallën e problemit shëndetësor të fëmijës tuaj, duke u bazuar tek ankesat e tij dhe elementët e tillë si temperatura, frymëmarrja, puls, dhimbja, etj.

Ky vlerësim paraprak i shpejtë është thelbësor, sepse ai mundëson dhënien e një shkalle të urgjencës (nga 1 në 5), për gjendjen e fëmijës tuaj. Kjo shkallë urgjence përcakton shpejtësinë e trajtimit mjekësor.



Trajtimi

Cilat janë etapat që i paraprijnë vizitës tek mjeku?


Një trajtim mjekësor i menjëhershëm mundësohet për të gjitha urgjencat jetësore (shkalla 1). Në situatat e tjera, ju do të akomodoheni në sallën e pritjes. Një trajtim kundër temperaturës së lartë apo dhimbjes mund të kryhet menjëherë nga infermieri(ja) pas vlerësimit paraprak.

Sapo të lirohet një dhomë, infermieri(ja) ju akomodon atje dhe fëmija juaj vizitohet nga një mjek, sapo ai të jetë i lirë. Gjatë pritjes, një asistent(e) mbikëqyr rregullisht gjendjen. Nëse ju vëreni shenja përkeqësimi, është e rëndësishme që të njoftoni menjëherë personelin mbikëqyrës.

A është e mundur të dish kohëzgjatjen e pritjes?

Në çdo moment, personeli mund t'ju japë një vlerësim të përafërt të kohës së pritjes. Megjithatë, ajo mbetet e përafërt, sepse mundet që ndonjë pacient i cili vjen pas jush, mund të ketë nevojë për kurim më urgjent, që mund të kërkojë mobilizimin e disa asistentëve njëkohësisht. Gjithsesi, shërbimi i urgjencave përpiqet që të reduktojë sa më shumë kohën tuaj të pritjes.

Një ekran ju informon në kohë reale mbi pozicionin e fëmijës tuaj në radhën e pritjes, sipas shkallës së tij të urgjencës. Ndiqni rrugëtimin e veturës me inicialet e tij.



Shkallët e urgjencës

Sa do të prisni për trajtim?

SHKALLËT E URGJENCËS	AFATET KOHORE TË REKOMANDUARA TË TRAJTIMIT
Shkalla 1: Reanimimi Shembull: Asfiksi	Menjëherë
Shkalla 2: Shumë urgjente Shembull: Krizë e fortë astme	15 minuta
Shkalla 3: urgjente Shembull: frakturë me zhvendosje e parakrahut	30 minuta
Shkalla 4: gjysmë-urgjente Shembull: plagë në mjekër	60 minuta
Shkalla 5: jo urgjente Shembull: Lia e dhenve	120 minuta

Do të njoftoheni me SMS

Në rast mbingarkese të shërbimit dhe të një pritjeje të gjatë, përdoret një sistem njoftimi me SMS. Ai ju jep mundësinë të largoheni përkohësisht nga shërbimi i urgjencave, nëse problemi shëndetësor i fëmijës tuaj e lejon diçka të tillë, duke ruajtur vendin tuaj në radhën e pritjes. Ju do të merrni një SMS 20 minuta përpara momentit të parashikuar për trajtimin e fëmijës tuaj, duke ju njoftuar për të ardhur në SAUP për konsultën.

Pse ndonjëherë trajtimi i fëmijës suaj mund të kërkojë kohë?

Pasi fëmija juaj të jetë akomoduar dhe vizituar nga mjeku, në disa raste mund të jeni të detyruar të prisni rezultate analizash, apo edhe mbërritjen e një specialisti, i cili mund të mos jetë i gatshëm menjëherë. Në disa raste të tjera, mjeku mund të ketë nevojë të mbikëqyrë mbarëvajtjen e gjendjes shëndetësore të fëmijës tuaj, çka mund të kërkojë disa orë.

Në dispozicion keni libra dhe lodra, mos hezitoni që t'ia kërkonti një infermier(e)je.

Nëse keni paqartësi, mos hezitoni të pyesni personelin mbikëqyrës.

Pas trajtimit

Info +


Faturimi

Në rast se ju vendosni të largoheni nga spitali, përpara se mjeku të ketë kryer vizitën, vlerësimi paraprak i kryer nga infermieri(ja) dhe pranimi i fëmijës faturohet. Ky shërbim i ngarkohet sigurimit bazë.

Çfarë ndodh pas ekzaminimit dhe arritjes së përfundimeve?

Mundësitë janë tre:

- Ju ktheheni në shtëpi dhe mjeku i urgjencave përpilon menjëherë një raport mjekësor, të cilin ia dërgon pediatri tuaj me email të sigurt.
- Gjendja e fëmijës tuaj kërkon mbikëqyrje deri në 24 orë, për të arritur në një vendim mbi një shtrim në spital, ose rikthim në shtëpi: në këtë rast akomodoheni në repartin e mbikëqyrjes mjekësore.
- Fëmija juaj duhet të shtrohet në spital. Në këtë rast shërbimi kujdeset që t'i gjej vendin më të përshtatshëm për situatën e tij. Në varësi të hapësirës në shërbimin spitalor, ndonjëherë mund të nevojitet një kohë e caktuar, derisa të mundësohet një shtrat i lirë. Ndërkohë, fëmija juaj qëndron në dhomën e vizitave, ose në repartin e mbikëqyrjes.

Përpara se të largoheni nga shërbimi i urgjencave, mos hezitoni të pyesni mjekun mbi çdo paqartësi, apo shqetësim përpara kthimit të shtëpi. Kërkoni çdo lloj certifikate që mund t'ju nevojitet (shkollë, sport, punë). Pasi të jeni kthyer në shtëpi, në rast nevojë ne jemi në dispozicionin tuaj në numrin  022 372 45 55.


Informacione shtesë

Vini re, shërbimi i urgjencave pediatrike:


- trajton nga 60 deri në 110 pacientë në ditë (25 000 në vit)
- ka rreth 70 sanitare profesioniste të specializuara në trajtimin e urgjencave pediatrike, 12 agjentë administrate, të grupuar në ekipe me turne, që shërbejnë 24 orë/24 dhe 7 ditë/7.
- ka një platformë teknike (radiologji, laborator, bllok operativ) të gatshme 24 orë/24.
- ka mjekë konsulentë dhe specialistë roje në gatishmëri, në shërbim 24 orë/24.

Informacione praktike

Shërbimi i pritjes së urgjencave pediatrike


Pr. Alain Gervaix, mjeku-shef i shërbimit
Annie-Claude Paubel, infermiere përgjegjëse e repartit
Avenue de la Roseraie 47, 1205 Genève
 022 372 45 55 (24orë/24)
www.hug-ge.ch/accueil-et-urgences-pediatriques
www.monenfantmalade.ch

Hôpital des enfants


Rue Willy-Donzé 6, 1205 Genève
 022 372 40 00

Gardes de pédiatrie Genève


Clinique Générale-Beaulieu

(18:00-22:00 ditë jave, 08:00-22:00 fundjavë dhe ditë festash)
Chemin de Beau-Soleil 20, 1206 Genève
 022 839 54 12

Clinique des Grangettes

(07:00-23:00 ditë jave, 08:00-23:00 fundjavë dhe ditë festash)
Chemin des Grangettes 7, 1224 Chêne-Bougeries
 022 305 01 11

Groupe médical du Petit-Lancy

(18:00-22:00 ditë jave, 08:00-22:00 fundjavë dhe ditë festash)
Avenue du Petit-Lancy 29, 1213 Petit-Lancy
 022 879 57 01

Hôpital de la Tour

(24orë/24)
Avenue Jacob-Daniel-Maillard 3, 1217 Meyrin
 022 719 61 00

Urgjencat jetësore

 144